


# Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

20 Shkurt 2017

## Seminar për nxitjen e të rinjve drejt sipërmarrjes



Ditën e Hënë, datë 20 Shkurt 2017, studentët e FASTIP morën pjesë në seminarin e zhvilluar nga Znj. Julia Goga Cooke dhe bashkëshorti i saj Z. Tim Cooke në lidhje me nxitjen e të rinjve drejtë sipërmarrjes.

Në këtë takim morën pjesë studentët e vitit të dytë të programeve të studimit Menaxhim i Bankave dhe Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme së bashku me profesorin e modulit të rradhës, Z. Vijaya Raju Mulagiri si aktivitet ekstra-kurrikular por në plotësim të modulit “Drejtim Projekti” që po zhvillohej ndërkohë.

Takimi u zhvillua pranë mjediseve të Innovation Hub në Tiranë ku zonja dhe zoti Cooke u treguan studentëve për të gjitha mundësitë dhe vështirësitë që hasin të rinjtë në rastin e hapjes së njëe biznesi të ri. Ato ndanë me studentët edhe eksperiencat e tyre jetësore si shembull pozitiv për suksesin e çdokujt.



Më tej studentët patën mundësinë t'i drejtonin pyetje zonjës dhe zotit Cooke për të sqaruar më tej çdo dilemë që mund të kishin.

Takimi u përmbyll me një catering tipik Indian të ofruar nga profesori Mulagiri për të gjithë studentët dhe pjesëmarrësit.